

RREGULLORE E BRENDSHME

Udhëzime për përdorimin e “Dhomës së sigurtë”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Rregullat për personin e autorizuar	3
Kufizime	4
Software në dispozicion të përdoruesve të "Dhomës së Sigurtë"	5
Shpërndarja e rezultateve.....	5



Hyrje

Aksesi në "dhomën e sigurtë" lejohet ekskluzivisht për punonjësit e autorizuar të Institutit të Statistikave, INSTAT, të cilët janë përgjegjës për funksionimin e saj dhe personat e autorizuar të listuar në kërkesën për sigurimin e të drejtës së hyrjes në të dhënat mikro pa identifikues.

"Dhoma e sigurtë" gjendet në ndërtesën e INSTAT. Orari i hapjes së "Dhomës së sigurtë" është në ditët e zyrtare të punës, nga e Hëna – Të Premte, nga ora 9:00 deri në orën 15:00.

Rregullat për personin e autorizuar

(në tekstin e mëtejshëm: përdoruesi) gjatë përdorimit të "Dhomës së sigurtë"

- Përdoruesi duhet të identifikohet para se të fillojë të punojë, duke paraqitur kartën e identitetit. Punonjësi i autorizuar i INSTAT, i cili është përgjegjës për "Dhomën e Sigurtë" është i detyruar të krahasojë të dhënat nga dokumenti i identifikimit të përdoruesit me të dhënat e Kontratës për shfrytëzimin (apo përdorimin) e të dhënave statistikore. Personi që nuk është i listuar në Kontratë si përdorues, nuk duhet të lejohet të hyjë në "Dhomën e Sigurtë".
- Procesi i identifikimit duhet të përfshijë edhe kontrollin e anekseve nga 1 deri në 4, të rregullores “E drejta për hyrje në të dhënat mikro”.
- Pas identifikimit, përdoruesi informohet për rregullat e punës në "Dhomën e sigurtë". Ai gjithashtu njoftohet në lidhje me “Kundërvajtjet administrative dhe gjobat” të përcaktuara në Ligj Nr. 17/2018, , “Per-statistikat-zyrtare”, për moszbatimin ose shkeljen e kërkesave të konfidencialitetit.
- Para hyrjes në dhomë, përdoruesi duhet të vendosë të gjitha sendet personale(çantë, telefon, laptop, etj) ne vendin e përcaktuar nga INSTAT.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- Përdoruesi lejohet të përdorë vetëm kompjuterin e përgatitur paraprakisht sipas kërkesës së paraqitur.
- Përdoruesi ka të drejtën e ndihmës profesionale të punonjësve të INSTAT të angazhuar në "Dhomën e Sigurtë". Ai / ajo mund të kërkojë dhe të marrë informacionin metodologjik që lidhet me vrojtimitet statistikore, udhëzimet për të ruajtur të dhënat në HD e kompjuterit, udhëzimet për përdorimin e software ekzistues në kompjuter, asistencë në rast të problemeve hardware ose software në funksionimin e kompjuterit.

Kufizime

Në "Dhomën e sigurtë" nuk lejohet:

- Printimi i dokumentave. Kompjuterat në "Dhomën e Sigurtë" nuk janë të lidhur me printer apo ndonjë pajisje tjetër printimi jashtë kësaj dhome.
- Kopjimi i të dhënave në ndonjë pajisje të jashtme për ruajtjen e të dhënave (HD të jashtëm, USB, Flash, DVD, CD, Bly-ray, Floppy, Tape).
- Kopjimi i të dhënave në HD të kompjuterit të "Dhomës së Sigurtë", përveç vendit të veçantë (dosjes elektronike) të paracaktuar dhe konfirmuar.
- Përdorimi i pajisjeve personale të TI dhe lidhja e tyre me kompjuterin në "Dhomës së Sigurtë" (Notebook, PDA, Tabela PC), si dhe mbajtja e pajisjeve të cilat mund të përdoren për fotografimin, krijimin e të dhënave video dhe audio dhe memorizimin e të dhënave (telefona celulare, regjistruar, kamera, etj).
- Përdorimi i çdo rrjeti (internet apo lokal).
- Mbajtja e shënimeve në formë jo elektronike dhe elektronike, përveç shënimeve të shkruara apo ruajtura në vendin e veçantë (dosjen elektronike), ku lejohet rruajtja e të dhënave veçantë.
- Bërja e ndonjë ndryshimi në parametrat sistematik të kompjuterit (data, koha, parametrat rajonalë, gjuha e ndërfaqes së përdoruesve).



Software në dispozicion të përdoruesve të "Dhomës së Sigurtë"

Komiteti i Konfidencialitetit vendos për versionet standard të software-ve që do të instalohen në kompjuterat e "Dhomës së sigurt".

Përdoruesi nuk lejohet të instalojë ndonjë software tjetër në kompjuter në "Dhomën e sigurtë", dhe ai / ajo nuk mund t'i drejtohet INSTAT dhe të kërkojë instalimin e software të nevojshëm për punën kërkimore në rast se nuk është instaluar në kompjuter.

Shpërndarja e rezultateve

Pasi përdoruesi të përfundojë analizën statistikore dhe ruajtjen e të dhënave në dosjen përkatëse të kompjuterit në "Dhomën e sigurt", kreu i sektorit përgjegjës për të dhënat statistikore kontrollon nëse rezultatet e analizës statistikore janë në përputhje me kontratën e nënshkruar dhe kërkesën për të përdorur "Dhomën e sigurt". Nëse nuk është kështu, përdoruesit i ndalohet përdorimi i të dhënave të përmendura. Pas marrjes së miratimit nga kreu i sektorit përgjegjës për mos shkeljen e kërkesave të konfidencialitetit, grupi teknik i konfidencialitetit miraton dërgimin e të dhënave tek përdoruesi. Dërgimin i të dhënave tek përdoruesi ndjek rrugën zyrtare të shpërndarjes së informacionit nga INSTAT.

Rezultatet e analizës statistikore u shpërndahen parashtruesve të kërkesës, sipas afatit dhe mënyrës së përcaktuar në kontratë. Këto rezultate i kalohen INSTAT për qëllime informacioni.

Për më shumë informacion mbi të drejtën për hyrje në të dhënat e INSTAT:

<http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/aksesi-në-mikrodata>;